



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
 - * Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)
- * Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
 - * Aktivitetet tjera

Nëntor 2019

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Etika Profesionale

Më 01 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), në mbështetje të GIZ – Projekti për Reformat Ligjore dhe Administrative ka realizuar trajnimin e obligueshëm “Etika profesionale”.



Qëllimi i realizimit të trajnimit ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve rreth përgjegjësi që dalin nga zbatimi i ligjit për përgjegjësinë, shkeljet dhe masat disiplinore, konkretisht

njohjes së kufirit dhe dallimit në mes shkeljes disiplinore dhe shkeljes procedurale.

Gjatë trajnimit janë prekur dhe diskutuar shumë çështje në lidhje me etiken profesionale në përgjithësi duke u fokusuar te shqyrtimi i ankesës nga autoritetet kompetente, propozimi i kryetarit për fillimin e procedurës disiplinore, formimi i panelit hetimor, si dhe vendimet e KGJK- së, pas marrjes së raporteve nga paneli hetimor.

Metodologjia e realizimit është përqendruar te debati interaktiv në mes te pjesëmarrësve duke shkëmbyer rastet nga praktika e tyre e punës se përditshme.

Përfitues të këtij trajnimi ishin Anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Kryetari i Gjykatës së Apelit si dhe Kryetarët e Gjykatave Themelore të Kosovës.



Roli dhe detyrat e gjyqtarit porotë në procedurë gjyqësore

Më 1 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “Roli dhe detyrat e gjyqtarit porotë në procedurë gjyqësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të rasteve nga praktika të ngritën kapacitetet profesionale me qëllim të respektimit të Kodit të Etikës.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan roli i gjyqtarit porotë në procedurën gjyqësore me theks të veçantë Kodi i Etikes që ka për qëllim parandalimin e sjelljeve jo etike si dhe parandalimin e konfliktit të interesit, sjelljeve jo korrekte dhe në fund edhe humbjen e besueshmërisë së qytetarëve dhe opinionit të

gjerë publik. Vëmendje iu kushtua çështjes se gjyqtarët porotë varësisht se në cilin nivel janë ata duhet të përkujdesen maksimalisht për paanësi dhe ta respektojnë atë me përkushtimin më të lart. Gjyqtari porotë duhet të jetë i pavarur, i drejtë dhe i paanshëm dhe atë ta ketë në konsideratë jo vetë sa është i angazhuar në një çështje gjyqësore por kjo ta përcjell atë gjatë gjithë kohës sa do ta mbaj funksionin e gjyqtarit që do të thotë në vazhdimësi.

Përfitues në këtë trajnim ishin Gjyqtarët Porotë nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Ekspertiza dhe shfrytëzimi i saj nga prokurorët në procedurën penale

Më 05 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), realizoi trajnimin me teme “Ekspertiza dhe shfrytëzimi i saj nga prokurorët në procedurën penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve për administrimin e ekspertizës nga ana e prokurorëve në procedurën penale.

Gjatë trajnimit janë trajtuar fushat e veçanta ku mund dhe duhet të caktohet ekspertimi, administrimi i ekspertizës gjatë shqyrtimit kryesor, vendimi për angazhimin e ekspertit dhe vlerësimi i raportit të ekspertit nga gjykata, llojet e ekspertizave sipas KPPK-së.

Po ashtu në trajnim është diskutuar edhe për rolin e analizave dhe shfrytëzimin e tyre nga ana

e prokurorëve në procedure penale siç janë: analizat toksikologjike, ekzaminimet e lëndimeve trupore dhe ekzaminimet fizike, analizat molekulare e gjenetike dhe analizat e ADN-së, analizat psikologjike /psikiatrike, analizat kompjuterike, analizat financiare, dhe ekspertiza mjeko ligjore.

Trajnimi është realizuar përmes diskutimeve interaktive si edhe përdorimit të rasteve praktike lidhur me ekspertizën.

Përfituesit të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorë e nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës si dhe bashkëpunëtor profesional.



Kodi doganor dhe i akcizave të Kosovës

Më 06 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), ka realizuar trajnimin me temë “ Kodi doganor dhe i akcizave të Kosovës ”

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me aplikimin dhe zbatimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan metodat e vlerësimit të mallit importues, metodat e vlerësimit të shpenzimeve të transportit duke analizuar Udhëzimin Administrativ nr.11/2009 dhe përcaktimi i kodeve tarifore. Po ashtu u trajtuan dispozitat ligjore që përmban Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës dhe

udhëzimet administrative përcjellëse për zbatimin e tij. Me theks të veçantë u diskutua për vendosjen e kodeve tarifore duke u mbështetur në dokumentacionet përcjellëse që duhet t'i bashkëngjiten Deklaratës Doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar dhe këshilltar profesional nga departamenti për çështje administrative - fiskale.



Shkaqet e anulimit të kontratave, me theks të veçantë të kontrata e shitjes

Më 07 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së dhe në mbështetje të GIZ-it organizoj trajnimin me temë: “Shkaqet e anulimit të kontratave, me theks të veçantë të kontrata e shitjes”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me shkaqet e anulimit të kontratave, me theks të veçantë të kontrata e shitjes.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan kontratat nule dhe kontratat e rrëzueshme. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan pasojat e nulitetit dhe anulimit të kontratave dhe konversioni. Tematika u trajtua në atë mënyrë që ofroi përgjigje pyetjeve, lidhur me kushtet të cilat duhet plotësuar për të ardhur deri te anulimi i kontratave dhe rrëzueshmëria e tyre, mënyrën e vendosjes dhe vlerësimi i afateve ligjore në rastet e tilla.

Më tej në trajnim u theksua se kontrata paraqet një nga burimet më të rëndësishme të detyrimeve dhe njëkohësisht institucionin qendror të komunikimit juridik në mes palëve kontraktuese. Që kontrata të jetë e vlefshme palët kontraktuese duhet të plotësojnë disa nga kushtet e parapara me ligj dhe në rastet kur kontrata është në kundërshtim me rendin publik, dispozitat urdhëruese ose moralin e shoqërisë, atëherë mund të vije deri të nuliteti i kontratës. Në rast se kontrata është lidhur nga pala me aftësi të kufizuar për të vepruar, apo ka pasur të

meta në pikëpamje të vullnetit të palëve atëherë vije deri tek rrëzueshmëria e kontratës.

Në vazhdim u potencua se në praktikë ka shumë raste kur palët kontraktuese nuk respektojnë kushtet e parapara për vlefshmërinë e kontratës, për çka edhe ka nevojë të trajtohen dhe analizohen shkaqet në bazë të të cilave mund të vije deri të anulimi dhe rrëzueshmëria e kontratës. Më tej u tha se kontratat relativisht të pavlefshme (kontratat e rrëzueshme) janë ato kontrata më anën e të cilave cenohen interesat individuale të palëve kontraktuese. Këto kontrata përmbajnë te meta apo mungesa të atilla të cilat nuk janë të pashërueshme, sepse nga vullneti i palëve kontraktuese varet se kontrata e lidhur a do të shpallet nule apo do të prodhoh efekt juridik të kontratës së vlefshme (konvalidimi i kontratave të rrëzueshme). Po ashtu rrezikshmëria e këtyre kontratave duke marrë për bazë cenimin e interesit individual të palëve është më e vogël në krahasim me kontratat absolutisht nule, tek të cilat çdoherë cenohet interesi i përgjithshëm shoqëror.

Duke trajtuar konversionin u potencua se për të ekzistuar konversioni i kontratës palët medoemos duhet të mos kenë dijeni për nulitetin e kontratës së lidhur, përndryshe nuk mund të flitet për konversion.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve studimore si dhe duke zbërthyer standardet dhe kërkesat e dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatave Themelore, të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional.

Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik - Sesioni II

Më 07-08 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, në bashkëpunim me UNDP, ka realizuar sesionin e dytë të trajnimit me temë “Program i Specializuar Trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik”.

Qëllimi i këtij sesioni trajnues ishte ngritja dhe forcimi i njohurive të pjesëmarrësve me elementet kyçe dhe tendencat e krimit kibernetik në mënyrë që të ndërtohen dhe fuqizohen kapacitetet profesionale në luftimin e kësaj dukurie negative si dhe prezantimi i Broshurës për çështjet kibernetike për prokurorët dhe gjyqtarë në Kosovës.

Në kuadër të këtij sesioni trajnues u trajtuan provat elektronike, procedura dhe praktika, marrja e provave elektronike, vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut, luftimi i rreziqeve të sig-

urisë virtuale si posta elektronike, viruset etj. Më tutje, u trajtuan zbulimi dhe parandalimi i pastrimit të parave dhe roli i forenzikës në zbulimin e krimit kibernetik. Gjatë këtij sesioni trajnues u përdorën metodat e krahasimit të legjislacionit vendor me atë ndërkombëtarë që e sanksionon krimin kibernetik si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në luftimin e kësaj dukurie.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, duke vënë në pah sfidat e vështirësitë në praktikë në rastet që ndërlidhen me këtë lloj të krimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ nga gjykatat dhe prokuroritë e regjione të ndryshme të Kosovës.



Zgjidhja Alternative e Kontesteve - Ndërmjetësimi

Më 11 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Programin e USAID-it-Drejtësia Komerciale organizoj punëtorinë-trajnimin me temë: “Zgjidhja Alternative e Kontesteve-Ndërmjetësimi”.

Ky trajnim kishte qëllim kryesor avancimin e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me mënyrat e zgjidhjes alternative të kontesteve me fokus ndërmjetësimin.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Roli dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me referimin e rasteve në ndërmjetësim dhe përgjegjësia që ka ndërmjetësuesi në raport me palët e përfshira në kontest gjatë mbajtjes së seancës të ndërmjetësimin. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Marrëveshjet për ndërmjetësim dhe përmbartimi i këtyre marrëveshjeve të arritura në procedurën e ndërmjetësimin.

Që në fillim u theksua se aktualisht në fuqi në Republikën e Kosovës është Ligji për Ndërmjetësim i shpallur me 20.08.2018. Ky ligj rregullon mënyrën, funksionimin, procedurën dhe organizimin e ndërmjetësimin, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesve me qëllim të lehtësimin të qasjes në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve dhe kontesteve si dhe të promovon zgjidhjen miqësore të tyre. Gjithashtu ky ligj është në pajtueshmëri me Direktivën 2008/52/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 21 maj 2008 në disa aspekte të ndërmjetësimin në çështje civile dhe komerciale.

Në vazhdim u theksua se aplikimi i formave alternative për zgjidhje të kontesteve, veçanërisht ndërmjetësimi është i një rëndësie të veçantë, pasi që rritë sigurinë juridike dhe mundëson tërheqjen e investimeve të huaja aq të nevojshme për zhvillimin e ekonomik, sepse në botën bashkëkohore të afarizmit bizneset dhe qytetarët, janë të interesuar për t'i zgjidhur kon-

testet e tyre jashtë procedurave gjyqësore.

Trajtimi i kësaj teme ishte me dobi dhe i domosdoshëm, pasi që gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës thelluan njohuritë për rregullat e reja



kombëtare dhe ndërkombëtare për ndërmjetësim, kuptuan përparësitë që ka ndërmjetësimi, pasojave ligjore të ndërmjetësimin, rolin e tyre në referimin e rasteve në qendrat e ndërmjetësimin dhe rolin e ndërmjetësuesve në harmonizimin e qëndrimeve tek palët e përfshira në kontest..

Më tej u theksua se Republika e Kosovës në përpjekjet e saj për krijimin e një sistemi juridik bashkëkohor, ka krijuar bazën juridike e cila mundëson zgjidhjen alternative të kontesteve.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve studimore si dhe duke zbërthyer standardet dhe kërkesat ndërkombëtare dhe dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore, prokurorët e prokurorive themelore dhe bashkëpunëtorët profesional si dhe ndërmjetësuesit.

Procedura penale me kryes madhor ku viktimat janë të miturit

Më 12 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), në mbështetje të GIZ – Projekti për Reformat Ligjore dhe Administrative ka realizuar trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë me temë: “Procedura penale me kryes madhor ku viktimat janë të miturit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të rasteve nga praktika të ngritën kapacitetet profesionale rreth veçorive të procedurës penale kur madhori kryen veprën penale ndaj të miturit.

Gjatë trajnimit është trajtuar procedura penale e cila zbatohet kur madhori kryen veprën penale kundër të miturit. Në të gjitha rastet kur

zbatohet procedura penale për veprën penale e kryer ndaj fëmijës, u potencua që autoritetet ose institucionet duhet të veprojnë me kujdes të posaçëm ndaj fëmijës i cili ka pësuar dëmtime nga vepra penale. Pra, duke e pasur parasysh moshën e tij, karakteristikat personale, edukimin dhe ambientin në të cilin jeton ai, në mënyrë që t’iu shmangen pasojave të mundshme të dëmshme për edukimin dhe zhvillimin e tij.

Kjo mbrojtje realizohet, duke vepruar me kujdes të posaçëm me qëllim të eliminimit të pasojave, që fëmija (viktima) ka pësuar gjatë kryerjes së veprës penale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional të nivelit themelor.



Fillimi dhe zhvillimi i procedurës së konfliktit administrativ

Më 13 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e GIZ-it organizoj trajnimin me temë: “Fillimi dhe zhvillimi i procedurës së konfliktit administrativ” në kuadër të PTV-së.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me fillimin dhe zhvillimin e procedurës së konfliktit administrativ.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, subjektet e procedurës administrative, akti administrativ, kontrata administrative, akti real, akti administrativ i miratuar në heshtje, procedura e mjeteve juridike ndaj aktit administrativ dhe përmbarimi i vendimeve administrative. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan konflikti administrativ, palët e autorizuar për fillimin e konfliktit administrativ, zhvillimi i procedurës së konfliktit administrativ, nxjerrja e aktgjykimit në konfliktin administrativ dhe procedura sipas mjeteve juridike.

Në vazhdim lidhur me procedurën e konfliktit administrativ u veçua tematika që lidhet me mbrojtjen gjyqësore dhe adresimin e ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit. U potencua se në procedimin e këtyre rasteve në gjykata po paraqiten dilema të ndryshme profesionale, procedurale dhe materiale përkitazi me vendosjen e këtyre lëndëve.

Në këtë trajnim pas një debati përmbajtjesor dhe shpjegimeve të trajnuesve u ofruan zgjidhje praktike të bazuara në ligj të cilat do të lehtësojnë punën e gjyqtarëve, dhe në instancë të fundit do të ndikojnë në reduktimin e përgjithshëm të numrit të lëndëve në gjykata. Po ashtu u shqyrtuan edhe sfidat praktike në këtë fushë përmes referimit në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut përfshirë dhe aspektet e avancimit të hartimit të akteve gjyqësore.

Në vazhdim u theksua se nëse gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative dhe kështu me aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar administrativ. Rrjedhimisht, me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore.

Ndërsa lidhur me mjetet juridike u theksua se procedura e konfliktit administrativ ashtu si edhe procedurat tjera gjyqësore parashohin dy lloje të mjeteve juridike - mjetet e rregullta dhe ato të jashtëzakonshme.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve studimore si dhe duke zbërthyer standardet dhe kërkesat e dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës, gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të

Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, zyrtarët e MPMS, të ATK-së dhe Doganës së Kosovës.

Procedura e falimentimit të shoqërive tregtare

Më 14 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me përkrahjen e World Bank Group - IFC me temë: "Procedura e falimentimit të shoqërive tregtare" në kuadër të



PTV-së. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me falimentimin, procedurën e likuidimit dhe riorganizimit të personave juridik në procedurën e falimentimit. Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Dispozitat e përgjithshme të Ligjit; procedurat e përshpejtuara (NVM dhe para-pakot); fillimi, hapja dhe pasojat e rastit; kërkesat e kreditorëve dhe riorganizimi. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Likuidimi; lirimi individual dhe mbyllja e rastit si dhe dispozitat ndërkufitare.

Në trajnim u theksua se Ligji i ri për falimentimin u paraqit si nevojë e domosdoshme për rregullimin e procedurës së likuidimit dhe riorganizimit të shoqërive tregtare, pasi ligji i mëparshëm ishte i pakompletuar, mbështetej në rregullore të cilat asnjëherë nuk ishin shpallur dhe si pasojë ky ligji u bë i pazbatueshëm. Ligji i ri për falimentimin përbën ligj gjithëpërfshirës mbi falimentimin dhe josolvencën, i cili i pasqyron praktikat më të mira ndërkombëtare, por përmban shumë institute dhe specifika tjera të cilat pothuajse ishin të panjohura në sistemin tonë juridik.

Në vazhdim u potencua se ky ligj rregullon

procedurat e likuidimit dhe riorganizimit të të gjitha shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe bizneset individuale, ortakëritë dhe shoqëritë komandite, që përbën ndryshim thelbësor nga ligji i vjetër. Ligji përmban nëntë kapituj në të cilët rregullon procedurën e riorganizimit dhe likuidimit duke përfshirë edhe konceptet e reja si: Lehtësimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Lirimi Individual dhe Procedurat ndërkombëtare. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji pritet një rritje e dukshme e rasteve, prandaj duke pasur parasysh risitë që sjell ky ligj dhe rritja e rasteve që pritet të paraqiten para gjykatave, trajtimi i kësaj tematike u vlerësua si shumë me rëndësi për avancimin e njohurive të gjyqtarëve në këtë lëmi. Ndërsa në fund u potencua se Ligji i ri e adopton Ligjin Model të UNCITRAL-it mbi Falimentimet ndërkufitare dhe u lejon administratorëve të huaj të hapin raste të kufizuara në Kosovë për t'i administruar asetet në Kosovë që janë pronë ose përfshijnë rast të huaj.

Gjatë këtij trajnimi u përdor dhe u aplikua një metodologji interaktive e cila përbëhej nga diskutimi dhe bashkëbisedimi, metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik mbi falimentimin, procedurën e likuidimit dhe riorganizimit të personave juridik në procedurën e falimentimit; prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore vendore dhe në regjion si dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, gjyqtarët e departamenteve të përgjithshme-divizionet civile të gjykatave themelore si dhe administratorët e falimentimit.

Aktgjykimi dhe llojet e aktgjykimit sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore

Më 19 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Aktgjykimi dhe llojet e aktgjykimit sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore” në kuadër të PTV-së. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me aktgjykimin si formë e vendosjes meritore dhe llojeve të aktgjykimeve që mund të nxjerr gjykata në një çështje juridike kontestimore.



Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Aktgjykimi, llojet e aktgjykimit dhe kushtet për nxjerrjen e tyre sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Përmbajtja e aktgjykimit dhe arsyetimi i secilit lloj të aktgjykimit.

Në fillim të trajnimit u potencua se Ligji për Procedurën Kontestimore për mënyrën meritore të vendosjes së kontesteve gjyqësore ka paraparë disa lloje të aktgjykimeve të cilat mund të nxirren nga gjykata, në rrethana të caktuara dhe me plotësimin e kushteve të veçanta procedurale. Vlerësimi i kushteve specifike për secilin lloj të aktgjykimit nga ana e gjykatave ka krijuar disa dilema të cilat po ndikojnë që në disa raste gjykatat t'i vlerësojnë në mënyrë të gabuar këto kushte, e rrjedhimisht edhe të nxjerrin përfundime përkatësisht aktgjykime me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore.

Në vazhdim u theksua se me aktgjykim gjykata vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë e cila është objekt i gjykimit. Me rastin e vendosjes për çështjen kryesore, gjykata është e lidhur më kërkesën e palëve. Ajo nuk mund të vendosë për asgjë tjetër, përveç për atë që ka kërkuar pala.

Gjykata me rastin e vendosjes meritore ka për detyrë që të vendosë për të gjitha kërkesat në mënyrë të plotë. Aktgjykimi përveç vendimit për çështjen kryesore përmban edhe vendimin për kërkesën aksesore si (kamata, penalitetet kontraktuese dhe shpenzimet e procedurës).

Lidhur me çështjen e arsyetimit të vendimeve gjyqësore u potencua se kjo është trajtuar edhe në kuadër të jurisprudencës kushtetuese në Kosovë, ku është konsideruar se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Ndërsa për çështjen e arsyetimit të vendimeve u potencua se në vendimet saj është marrë edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku ndër të tjera është thënë se: “Arsyetimi i aktgjykimit është një përbërës kyç i gjykimit të drejtë dhe është esencial për ndarjen e drejtësisë dhe është treguesi më i mirë që dëshmon se gjykatat i kanë të bazuara thëniet në vendimet e tyre. Funksion i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar. Nga ana tjetër, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të realizohet një kontroll publik i administrimit të drejtësisë”.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve nga praktika e pasur gjyqësore duke zbërthyer dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi si dhe duke sqaruar paqartësitë e përmendura më lartë.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore, të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional.

Etika profesionale-Grupi I Anëtarët e panelit hetimor GR. I

Më 19-20 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në mbështetje të GIZ – Projekti për Reformat Ligjore dhe Administrative ka realizuar trajnimin e obligueshëm “Etika profesionale” për anëtarët e panelit hetimor, GR. I.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të përfituesve me standardet e Kodit të Etikës dhe pozicionit të Kodit të Etikës në raport me përgjegjësin dhe procedurën disiplinore.

Në fokus të këtij trajnimi kanë qene Kodi i Etikës dhe parimet bazë të etikës profesionale siç janë pavarësia, paanshmëria, barazia, integriteti, profesionalizimi dhe përgjegjësia në punë, konfidencialiteti dhe raportet me publikun dhe mediat, rregullorja për përcaktimin e sjelljeve të pahijshme, definimi i sjelljeve të pahijshme, kategorizimi i sjelljeve të

pahijshme, përgjegjësia, shkeljet dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve si dhe procedura disiplinore.

Po ashtu gjatë trajnimit është diskutuar edhe për Panelin Hetimor dhe mënyrën e themelimit të Panelit Hetimor, i cili ka për mandat hetimin e shkeljeve të supozuara disiplinore nga lista e gjyqtarëve panelist të cilët zgjidhen me short dhe të cilët vijnë nga gjykata tjera dhe jo nga gjykata të cilës i përket gjyqtari që hetohet.

Trajnimi është realizuar përmes prezantimit teorik duke u shoqëruar me pyetje dhe diskutim interaktiv në mes të pjesëmarrësve dhe trajnuesve të angazhuar.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarë nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit si dhe gjykatat themelore nga regjione të ndryshme të Kosovës, të gjithë Anëtarë të panelit hetimor, GR. I.



Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve

Më 21 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, e përkrahur nga Ambasada Franceze - Ministria e Drejtësisë së Francës, organizoj trajnimin me temë: “Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve”. Ky trajnim kishte



për qëllim avancimin e njohurive të gjyqtarëve lidhur me tematikën e rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile - parimet e bashkëpunimit dhe legjislacioni e zbatimi i tij në praktikë. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Ligji për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës dhe raste studimore nga praktika të shoqëruara me diskutim dhe debat interaktiv.

Që në fillim u theksua se Konventa e Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës është aprovuar me 25 tetor 1980, ndërsa ka hyrë në fuqi më 01 dhjetor 1983. Procesin e aderimit e shoqëron nënshkrimi, ratifikimi nga ana e shtetit të ri anëtarë dhe pas kësaj hyrja në fuqi. Çdo aderim i ri duhet të pranohet veç e veç nga shtetet që tashmë janë shtete anëtare - vetëm atëherë hyn në fuqi Konventa ndërmjet shtetit të ri aderues dhe shtetit të vjetër kontaktues.

Më tej në trajnim u prezentuan zhvillimet e fundit në legjislacionin vendor ku u potencua se

aktualisht në Republikën e Kosovës vlen Ligji për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës si ligj kombëtar, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 89 me 30 nëntor 2010. Ky ligj paraqet në shkallë të gjerë dispozitat e Konventës së Hagës për Rrëmbimin e Fëmijës, përmban dispozita kombëtare zbatuese, për shkak të së drejtës procedurale i referohet Ligjit të Procedurës Jokontestimore dhe interpretohet si dhe zbatohet në pajtim me Konventën e përmendur.

Më tej në trajnim u potencua se Ligji i Rrëmbimit dhe Konventa bazohen mbi pikëpamjen, se në përgjithësi është në kundërshtim me interesat e fëmijës, që befas/kundër dëshirës së prindit tjetër dhe në mënyrë të paligjshme ai të nxirret nga rrethi i zakonshëm i jetës, sepse kjo pengon zhvillimin e tij dhe kryesisht e kufizon fort raportin me prindin e braktisur. Gjithashtu është në të mirën e fëmijës, që e drejta e kujdestarisë dhe e drejta e kontaktit që ekziston në një shtet kontraktues të respektohet vërtet edhe në shtetin tjetër. Ligji i Rrëmbimit dhe Konventa do të duhej të mbrojnë në këtë mënyrë të drejtën e kujdestarisë së prindit të braktisur dhe të sigurojë që fëmijët të kthehen sa më shpejtë që mundet në rrethin e tyre të zakonshëm.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, metodat bashkëkohore duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore dhe shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, analizës së rasteve studimore dhe standardeve bashkëkohore si dhe konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi në lëmin e rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Përfitues në këtë trajnim ishin: gjyqtarët e gjykatave themelore të Republikës së Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional si dhe zyrtarë nga Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i Ministrisë së Drejtësisë.

Zbatimi i së drejtës së Bashkimit Evropian nga ana e Gjykatave nacionale, veçmas në Republikën e Kosovës dhe efekti i saj në interpretativ para anëtarësimit



Më 26 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Zbatimi i së drejtës së Bashkimit Evropian nga ana e gjykatave nacionale – veçmas në Republikën e Kosovës dhe efekti i saj interpretativ para anëtarësimit” në kuadër të PTV-së.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me efektin e të drejtës së Bashkimit Evropian në nivel nacional veçmas pas hyrjes në fuqi të MSA-së.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Zbatimi i së drejtës evropiane dhe efektet e saj në nivel nacional (efekti e drejtpërdrejt dhe i tërthortë) dhe efekti i saj në sistemin kushtetues dhe të drejtën e Republikës së Kosovës pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim-Asocimin. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Zbatimi i së

drejtës së BE-së nga ana e gjykatave nacionale në Republikën e Kosovës përmes shembujve praktikë.

Në fillim u theksua se Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim (MSA) gëzon efekt direkt pas ratifikimit të Ligjit Nr. 05/L-069 për ratifikim të MSA-së ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike. Sipas MSA-së në nenin 74 përcaktohet obligimi për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis e BE-së. Ky nen në detaje përkufizon fushat prioritare të acquis që duhet të transpozohen në legjislacionin vendor, në fushën e tregut të brendshëm, fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, si dhe fushat e lidhura me tregti.

Duke diskutuar për doktrinën e efektit të tërthortë, u theksua se është e mundshme dhe e dobishme të zbatohet edhe në të drejtën kosovare në periudhën e para anëtarësimit. Në të vërtetë, me MSA-në Kosova ka marrë obligimin e harmonizimit e të drejtës së saj me atë evropiane. Dobia e qasjes së tillë është në atë që të siguroj harmonizimin e të drejtës kosovare me atë evropiane. Harmonizimi, në të vërtetë, nuk është përfunduar me aprovimin e dispozitave të caktuara, por tek atëherë kur është zbatuar në praktik e cila është e ngjashme me zbatimin në BE-së. Përgjegjësia, pra, për harmonizimin e të drejtës kosovare me të drejtën e BE-së nuk është vetëm në legjislativin, por edhe në gjykata. U veqta konkludimi se ka vështirësi dhe dilema që lidhen me zbatimin efektiv të së drejtës evropiane në nivel nacional në vështrim të praktikës së gjykatave të shtetit që nuk është ende anëtarë i BE-së por që aspiron anëtarësimin në BE.

Në vazhdim u potencua se sipas MSA-së qartë përcaktohet obligimi për përafrimin e

legjislacionit të Kosovës me *acquis communautaire*. Duke diskutuar për katër liritë (lirinë e lëvizjes së të mirave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve) u potencua se këto janë të inkuorpuara në dispozitat themelore të Kushtetutes së Kosovës dhe se Gjykata e Drejtësisë e BE-së (GJDBE) përmes praktikës së saj ka definuar kuptimin e tyre, praktikë kjo e cila vazhdimisht zhvillohet në drejtim të forcimit të autorizimeve të Bashkimit Evropian.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve nga praktika gjyqësore duke zbërthyer dispozitat e burimeve ligjore të BE-së dhe atyre nacionale në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

Etika profesionale-Anëtarët e panelit hetimor Gr.II

Më 26-27 Nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në mbështetje të GIZ – Projekti për Reformat Ligjore dhe Administrative ka realizuar trajnimin e obligueshëm “Etika profesionale” për anëtarët e panelit hetimor, GR. I.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të përfituesve me standardet e Kodit të Etikes dhe pozicionit të Kodit të Etikes në raport me përgjegjësin dhe procedurën disiplinore.

Në fokus të këtij trajnimi kanë qenë Kodi i Etikës dhe parimet bazë të etikës profesionale siç janë pavarësia, paanshmëria, barazia, integriteti, profesionalizimi dhe përgjegjësia në punë, konfidencialiteti dhe raportet me publikun dhe mediat, rregullorja për përcaktimin e sjelljeve të pahijshme, definimi i sjelljeve të pahijshme, kategorizimi i sjelljeve të

pahijshme, përgjegjësia, shkeljet dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve si dhe procedura disiplinore.

Po ashtu gjatë trajnimit është diskutuar edhe për Panelin Hetimor dhe mënyrën e themelimit të Panelit Hetimor, i cili ka për mandat hetimin e shkeljeve të supozuara disiplinore nga lista e gjyqtarëve panelist të cilët zgjidhen me short dhe të cilët vijnë nga gjykata tjera dhe jo nga gjykata të cilës i përket gjyqtari që hetohet.

Trajnimi është realizuar përmes prezantimit teorik duke u shoqëruar me pyetje dhe diskutim interaktiv në mes të pjesëmarrësve dhe trajnuesve të angazhuar.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, Gjyqtarë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme si dhe gjykatat themelore nga regjione të ndryshme të Kosovës, të gjithë Anëtarë të panelit hetimor, GR. II.



Pronësia intelektuale në aspektin civil dhe penal



Më 29-30 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim dhe me ndihmën e Projektit të GIZ-it- “Përkrahje e Procesit të Integritimit Evropian” organizoj trajnimin me temë: “Pronësia Intelektuale në aspektin Civil dhe Penal”. Ky trajnim kishte për qëllim avancimin e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës në lëmin e sistemit të të drejtave të pronësisë intelektuale (pronësisë industriale dhe të drejtave të autorit) në Republikën e Kosovës.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan: Sistemi i të drejtave të pronësisë intelektuale në Republikën e Kosovës; Të drejtat e pronësinë industriale me theks të veçantë markat tregtare – regjistrimi dhe fitimi i të drejtave, legjislacioni dhe perspektiva e BE-së; Markat tregtare sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës; Masat e përkohshme në procedurën civile dhe mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të autorit, si dhe Raste gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së BE-së në procedurë të regjistrimit të markave tregtare dhe lidhur me shkeljen e të drejtave që burojnë nga ato (fusha administrative dhe civile).

Në ditën e dytë u trajtuan: Përgjegjësia penale për shkeljen e të drejtave të pronësisë industriale -të drejtave të autorit në vendet e BE-së për

shkeljen e të drejtave të autorit dhe legjislacioni i Republikës së Kosovës; Shkeljet në internet dhe të drejtat e pronësisë industriale si dhe shkeljet online dhe të drejtat e autorit si dhe raste nga praktika gjyqësore.

Që në fillim u theksua se mbrojtja e markave tregtare në Republikën e Kosovës garantohet me Ligjin për Markat Tregtare, Kodin Penal si dhe me masat tjera administrative duke përfshirë ato doganore, megjithatë në praktikën juridike hasen vështirësi të shumta në zbatimin e dispozitave ligjore dhe ofrimin e mbrojtjes efektive.

Më tej u potencua se në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga markat tregtare është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, andaj fokusi në këtë tematikë ishte me dobi për avancimin e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë lëmi. Sipas standardeve ndërkombëtare të përcaktuara veçmas me Marrëveshjen TRIPS dhe direktivat e BE-së, shtetet duhet të sigurojnë mjete juridike të lehta, efektive dhe jo të kushtueshme në mënyrë që bartësit të mos hezitojnë të e kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre pranë gjyqësorit.

Lidhur me të drejtat e autorit u theksua se në bazë të Konventës së Bernës, një ndër konventat kryesore ndërkombëtare për të drejtën e autorit, vepër e autorit, konsiderohet vepra letrare dhe artistike, që përfshin çdo prodhim të domenit shkencor, letrar dhe artistik, në çfarëdo forme të shprehjes. Ky përkufizim, i lejon hapësirë manovruese shteteve anëtare të Konventës, lidhur me përcaktimin se cilat janë veprat e mbrojtura, dhe kushtet të cilat duhet një vepër ti plotësoj për të gëzuar mbrojtje. Në bazë të legjislacionit tonë, veprat e autorit janë krijimet intelektuale origjinale në lëmin e letërsisë, të shkencës dhe artit dhe që janë të shprehura në çfarë do mënyre.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e

shpjegimit të pjesshëm teorik, raste nga praktika gjyqësore, ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve dhe standardeve ndërkombëtare dhe evropiane në këtë lëmi. E tërë kjo u shoqërua me paraqitje të rasteve nga praktika e GJDBE-së dhe rasteve praktike gjyqësore në vendin tonë.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët nga Departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës së Apelit dhe i Gjykatës Themelore në Prishtinë si dhe gjyqtarët e prokurorët nga lëmia penale të cilët i vendosin lëndët e natyrës së krimit financiar me theks markat tregtare dhe çështjet e të drejtës së autorit.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII)

Komponenta e trajnimit teorik, për këtë periudhë, është përmbushur duke realizuar aktivitetet si në vijim: gjithsejtë 18 sesione trajnuese janë realizuar nga modulet: Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinore, Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese dhe Kodi i Procedurës Penale.



Në kuadër të nën modulit “Arsyetime të vendimeve gjyqësore” janë realizuar nëntë (9) sesione trajnuese ku u trajtuan: Shkrimi ligjor, parimet e shkrimit ligjor, metodologjia e përdorimit të Formulës IRAC, arsyetimi ligjor, uniteti i paragrafit dhe analiza për mundësinë e zbatimit të metodologjisë “IRAC” në hartimin e aktgjykimit në lëndët civile.

Nga nën-moduli “Menaxhimi i rasteve” janë realizuar tri (3) sesione trajnuese ku gjyqtarët e sapoemëruar patën rastin të përfitojnë njohuri të reja lidhur me rendësinë dhe parimet e menaxhimit të rrjedhës së lëndës dhe qëllimi i punës së gjykatave dhe metodat themelore në menaxhimin e lëndëve.

Gjatë realizimit të trajnimeve në muajin nëntor nga nën moduli “Ligji për kundërvajtje” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ndër të cilat u shtjelluan: Fillimi dhe zhvillimi i procedurës së kundërvajtës si dhe mjetet e rregullta juridike dhe të jashtëzakonshme juridike dhe Procedura sipas ankesës.

Gjithashtu gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar trajnimin nga nën moduli “Marrja dhe komunikimi i vendimeve dhe dërgimi i shkresave” një (1) sesion trajnuese në të cilin është trajtuar procedura për marrjen e vendimeve në seancë për këshillim dhe votim nga trupi gjykues dhe komunikimi i vendimeve.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe nga nën-moduli “Ngritja e shkathtësive gjyqësore” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ku gjyqtarët e sapo emëruar patën rastin të ngritin kapacitetet e tyre rreth mjedisit social, konflikteve dhe ngritjen e shkathtësive sociale si predispozite e avancimit të performances profesionale.

Në kuadër të trajnimit praktik, për këtë periudhë është realizuar trajnimi përmes vijimit të praktikës nga ana e gjyqtarëve të sapoemëruar në gjykatat përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program.

Gjyqtarët e sapoemëruar, gjatë muajit nëntor po ashtu kanë realizuar trajnimin praktik/vizitë në Shërbimin Sprovues, Agjencinë e Administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe në Institucionin e Avokatit të Popullit të cilët kanë pasur mundësi të diskutojnë për rolin, strukturën dhe problemet e shfaqura në praktikë.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 39 gjyqtarë të sapoemëruar, ku shtatë prej tyre janë nga komuniteti serb.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e VIII)

Programi i trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara për muajin nëntor.

Në kuadër të trajnimit teorik për prokurorët e sapo emëruar janë realizuar (16) sesione trajnuese nga moduli “Kodi i Procedurës Penale”.

Nga nën moduli “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese, ku u trajtuan thirrja, urdhër arresti dhe premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi i të pandehurit për t’iu afruar vendit të caktuar dhe personave të caktuar, obligimi i të pandehurit për paraqitjen më të afërt në stacionin policor dhe dorëzania dhe arresti shtëpiak, diversioni dhe paraburgimi.

Në kuadër të nën modulit “I pandehuri në procedurën penale” janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese, ku prokurorët e sapo emëruar patën rastin të thellojnë njohurit e tyre lidhur me të pandehurin si subjekt i procedurës penale dhe gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, të drejtat e tij për ushtrimin e mjeteve juridike duke theksuar pozitën e të pandehurit pas ngritjes dhe gjatë procedurës së konfirmimit të aktakuzës.

Gjithashtu prokurorët kanë realizuar pesë (5) sesione nga nën moduli “Dëshmitarët dhe të

dëmtuarit në procedurën penale” ku pjesëmarrësit u informuan rreth marrjes në pyetje dhe e deklaratave të dëshmitarëve para ngritjes së aktakuzës, dëshmitarët e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunues si dhe i dëmtuari dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor.

Po ashtu nga nën modulit “Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese ndër të cilat janë shtjelluar: Kushtet ligjore për autorizimin e masave të fshehta dhe të drejtat e personave të atakuar si dhe përgjimi i telekomunikimeve dhe regjistrimi i bisedave telefonike me anë të hetimeve të fshehta dhe nga zbulimi i të dhënave financiare. Po ashtu, në drejtim të përmbushjes së programit praktik me institucionet jo gjyqësore, gjatë muajit nëntor prokurorët e sapo emëruar kanë vijuar trajnim edhe në Shërbimin Sprovues, dhe në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës, ku prokurorët patën rastin të përfitojnë njohuri lidhur me punët të cilët i zhvillojnë këto institucione.

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar (10) ditë trajnimi praktik në prokurorit përkatëse ashtu siç është paraparë me programin trajnues. Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 12 prokurorë të sapo emëruar.



Trajnim praktik i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar në Shërbimin Sprovues të Kosovës

Më datën 06 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar, ka realizuar trajnimin praktik me Shërbimin Sprovues të Kosovës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar të njoftohen me rolin, funksionin dhe përgjegjësitë e Shërbimit Sprovues të Kosovës.

Në kuadër të këtij trajnimi praktik u prezantua themelimi, organizimi, dhe funksionet e Shërbimit Sprovues të Kosovës. Po ashtu, u trajtuan veprimtaria e Shërbimit Sprovues, zbatimi dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të dënimeve alternative, ri-integrimi i personave të dënuar, mbikëqyrja dhe ndihma ndaj kryerësve

të veprave penale të varur nga droga, ose alkooli të cilët i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm rehabilitues, si dhe ndihma ndaj personave të dënuar të liruar me kusht.

Fokusi i këtij trajnimi u përqendrua tek bashkëbisedimi nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ngritja e vetëdijes shoqërore dhe bashkëpunimi me të gjitha organet e pushtetit shtetëror për humanizmin e ekzekutimit të dënimeve ndaj të miturve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VII-të dhe prokurorët e sapo emëruar gjenerata e VIII e PTF-së.



Trajnim/ vizitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik

Më 20 nëntor 2019, në kuadër të programit praktik për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar, Akademia e Drejtësisë ka realizuar vizitën e radhës në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar të njoftohen me rolin, funksionin, përgjegjësitë e prokurimit publik elektronik, si dhe monitorimin e KRPP-së në institucion, të paraparë me legjislacionin për prokurimin publik në Kosovë.

Gjatë trajnimit u shtjelluan procedurat dhe fazat e prokurimit publik, mënyra dhe mekanizmat e funksionimit të platformës së prokurimit publik

elektronik, legjislacioni pozitiv rreth prokurimit publik, si dhe legjislacioni primar dhe sekondar që rregullon këtë fushë. Diskutimet janë zhvilluar rreth aplikimit online përmes një platforme “E-prokurim” e cila e bënë më të lehtë formën e aplikuesve për prokurim publik e cila do të fillojë të implementohet në vitin e ardhshëm.

Gjithashtu u elaboruan edhe vështirësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion në përmbushjen e përgjegjësisë të saj kur kemi të bëjmë me rastet e keqpërdorimeve të veprat penale të kryera nëpërmjet prokurimit publik si dhe u diskutua rreth ngritjes së bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet institucioneve të sistemit gjyqësor me qëllim të adresimit dhe eliminimit të këtyre sfidave në praktikë.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata VII) dhe prokurorët e sapo emëruar (gjenerata VIII) 2019-2020.



Trajnim praktik i prokurorëve të sapo emëruar me Gjykatën Kushtetuese

Më 22 Nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimeve Fillestare për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e VII) ka organizuar trajnimin praktik me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njoftimi i prokurorëve të sapo emëruar me rolin dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, si dhe raporti i kësaj gjykate me gjykata e rregullta dhe institucionet e tjera.

Në kuadër të këtij trajnimi u diskutua rreth procedimit të kërkesës, vendimmarrja dhe efekti i vendimeve të kësaj gjykate. Më tej janë trajtuar kërkesat individuale, kontrolli incidental si dhe bashkëpunimi me Komisionin e Venecias. Po ashtu, me theks të veçantë u diskutuan kërkesat të cilat adresohen nga Avokati i Popullit të orientuara nga presidenti i

vendit, qeveria si dhe nga OJQ-të e ndryshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu u diskutua lidhur me modelet e trajtimeve të gjykatave rajonale lidhur me numrin e kërkesave individuale dhe të drejtave individuale për të adresuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, vendimet e Gjykatës Kushtetuese për ngritje të çështjes dhe refuzimi i kërkesave të Gjykatës Kushtetuese.

Në kuadër të këtij trajnimi me rëndësi të veçantë u shtjellua edhe numri i lëndëve të shqyrtuara, vendimet e gjykatës në raport me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përfitues të trajnimit ishin: Prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e VII), 2019-2020.



Vizitë e gjyqtarëve të sapo emëruar në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP)

Më 26 nëntor 2019, në kuadër të trajnimit praktik për gjyqtarët e sapo emëruar, Akademia e Drejtësisë, ka realizuar vizitën e radhës në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Qëllimi i vizitës ishte njohja e gjyqtarëve të sapoemëruar me mandatin, rolin, strukturën organizative dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion.

Në kuadër të kësaj vizite, gjyqtarët e sapo emëruar patën mundësi të informohen rreth trajtimit të çështjeve të adresuara tek Avokati i Popullit lidhur me procedurat si dhe sfidat e përgjithshme, me të cilat ballafaqohen.

Rëndësi të veçantë i është kushtuar procedurës së shqyrtimit të ankesave që paraqiten në IAP, duke përfshirë këtu edhe ankesat e qytetarëve drejtuar ndaj gjyqësorit, puna e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve tjera mizore,

jonjerëzore dhe poshtëruese.

Gjithashtu është diskutuar relacioni i Institucionit të Avokatit të Popullit me gjyqësorin dhe prokurorin si dhe institucionet e tjera duke përfshirë vështirësitë që hasen në bashkëpunimin ndërinstytucional dhe respektimin e rekomandimeve që jep IAP në drejtim të institucioneve publike.

Vizita është zhvilluar në formë të bashkëbisedimit, duke parashtruar pyetje dhe diskutuar çështje të interesit të përbashkët e që ndërlidhen me punën e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata VII).



Aktivitetet nga Programi për hulumtime dhe Publikime (PHP)

Prezantimi i platformës së mësimit në distancë, bibliotekës ligjore elektronike të AD-së

Më 04 dhe 5 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me OSBE-në ka realizuar dy punëtori një për regjionin e Pejës dhe një për regjionin e Gjilanit me temë “Prezantimi i platformës së mësimit përmes internetit, bibliotekës ligjore elektronike të AD-së.

Qëllimi i këtyre dy punëtorive ishte njoftimi nga afër me shërbimet e teknologjisë informative që ofron Akademia e Drejtësisë për përfituesit e saj si: web-faqja e AD-së, aplikimi online për trajnime, funksionimi i platformës së mësimit në distancë, kyqja në platformë, aplikimi për kurse trajnuese, ndjekja e trajnimeve përmes platformës, kyqja në bibliotekën elektronike të Akademisë, gjetja e literaturës në

këtë bibliotekë, dhe literatura që posedon biblioteka fizike e Akademisë.

Me rastin e këtyre punëtorive është demonstruar praktikisht nga pjesëmarrësit qasja në platformat dhe data bazat që ofron Akademia në mënyrë që të ardhmen të jenë shfrytëzues të burimeve dhe materialeve ligjore që ofrojnë këto platforma.

Pjesëmarrës në këto punëtori ishin gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor nga regjioni i Pejës dhe Gjakovës.



Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Integriteti dhe sjelljet etike

Më 6 dhe 7 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të trajnimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive ka realizuar trajnimin me temë “**Integriteti dhe sjelljet etike**”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi në respektimin e sjelljes etike dhe vendosjen e standardeve të integritetit moral dhe udhëzimeve për sjellje të hijshme personale dhe profesionale të stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan çështjet rreth administratës gjyqësore dhe prokuroriale në Kosovë me theks të veçantë sjelljet etike. Me rastin e këtij trajnimi u potencua që prioriteti i sistemit gjyqësor dhe prokurorial, është rritja e cilësisë së performancës profesionale, duke siguruar zbatimin e duhur praktik të parimeve

dhe standardeve etike në përputhje me Kodin e Etikës siç janë: profesionalizmi, disiplina në punë, paañësia, pavarësia, konfidencialiteti, shmangia nga konflikti i interesit dhe nga sjelljet e pa hijshme, ndershmëria dhe llogaridhënia.

Për të pasur një prestigj dhe imazh të mirë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial ka nevojë që të ketë staf administrativ i cili duhet të respektojë rregullat dhe standardet etike jo vetëm gjatë kohës sa është në zyrë në orarin e punës, por edhe jashtë zyrës pas orarit të punës, sepse ata paraqesin pasqyrën e të punësuarve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Përfitues të këtij trajnimi ishin stafi administrativ i gjykatave dhe prokurorive nga gjitha regjionet e Kosovës.



Aktivitetet tjera

Punëtorja për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2020

Më 04-05 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë realizoi “Punëtorinë për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2020”.

Qëllimi i punëtorisë ishte hartimi i Programit Trajnues për vitin 2020, adekuat me nevojat reale të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe në përgjithësi me sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Fillimisht, me rastin e kësaj punëtorie është prezantuar një analizë e temave që kanë dale si rezultat i zhvillimit të mekanizmave për vlerësimin e nevojave dhe temave që kanë qenë pjese e programeve trajnues për tri vitet e fundit. Në vazhdim janë vendosë konturat e draft Programit Trajnues, duke përzgjedhur temat potenciale varësisht nga fushat përkatëse.

Ekspertët e angazhuar duke u mbështet në kërkesën e Akademisë së Drejtësisë rreth strukturës së përgjithshme që duhet të përmbajë Programi Trajnues, kanë përcaktuar temat me prioritet që duhet të trajtohen gjatë vitit 2020. Programi Trajnues 2020 do të jetë program një vjeçar dhe përmban tema të karakterit profesional ligjor dhe atij ndërdisiplinor dhe do të reflektoj nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe kërkesat e dala nga politikat dhe strategjitë e vendit për gjyqësorin.

Në draft programin trajnues janë përfshirë edhe temat e propozuara nga partnerët e Akademisë. Bazuar në strukturën e përcaktuar për Programin Trajnues 2020, është hartuar koncepti i secilit trajnim duke u mbështetur në sfidat dhe problemet e shfaqura në praktikën gjyqësore në vend.

Koncepti i temës përfshinë qëllimin, ku bëhet përshkrimi i temës, evidentohen dilemat dhe përshkruhet qasja në adresimin e këtyre dilemave gjatë trajnimit, përmbajtjen, metodologjinë trajnuese, përfituesit e trajnimit si dhe kohëzgjatjen e trajnimit.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin trajnuesit e përherëshëm dhe trajnuesit Akademisë së Drejtësisë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve.



Trajnimi për Trajnues-Titujt juridik për fitimin e pronësisë - sfidat në vërtetimin e titullit juridik

Më 08 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e Bashkimit Evropian-Projekti për Kodin Civil organizoj trajnimin për trajnues me temë: “Titujt juridik për fitimin e pronësisë - sfidat në vërtetimin e titullit juridik”. Ky trajnim ishte në funksion të përgatitjes së trajnuesve për trajnimet që do të organizohen në të ardhmen dhe avancimin e njohurive të tyre lidhur me risitë që do të sjell Kodi Civil i Republikës së Kosovës i cili është në fazën e miratimit të tij.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Titujt juridik për fitimin e pronësisë, llojet e titujve juridik, vërtetimi i titujve juridik, dhe baza më e fortë juridike për fitimin e pronësisë. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Parashkrimi si titull juridik, vështirësitë e vërtetimit të parashkrimit, konkurrenca e titujve juridik-parashkrimit dhe certifikatës/fletës poseduese të pronësisë.

Që në fillim u theksua se aktualisht në fuqi është Ligji i Pronësisë dhe të Drejtave Tjera Sendore (LPDTS) që ka hyrë në fuqi në fuqi me datën 20 Gusht 2009 e i cili rregullon institutet si: Pronësinë, Posedimin, Pengun në sendet e luajtshme, Hipotekën në sendet e paluajtshme, Servitutet, Barrët sendore dhe të Drejtën e ndërtimit.

Më tej në trajnim u prezantuan zhvillimet e fundit në Projekt-Kodin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin do të bëhen zhvillime të rëndësishme në të drejtat pronësore si: Janë harmonizuar dispozitat ligjore dhe Kodi përmban 5 Libra: Libri 1- Pjesa e përgjithshme, Libri 2- Detyrimet, Libri 3- Pronësia dhe të drejtat tjera sendore, Libri 4- Familja, dhe Libri 5- Trashëgimia. Ky Kodi Civil do të ketë gjithsejtë 1632 nene dhe është në procedurë të miratimit në Qeveri.

Më tej në trajnim u veçuan risitë që sjell Kodi Civil i Republikës së Kosovës si në vijim: duke bërë përkufizimet e pronësisë, janë specifikuar dhe sqaruar kuptimi i dispozitave ligjore, personat e huaj mund të fitojnë të drejta sendore, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë, është sqaruar mirëbesimi dhe keqbesi-

mi, për pronësinë në kafshë, ka rregulla të veçanta, janë përcaktuar llojet e pronësisë - publike dhe private, janë sqaruar të drejtat fqinjësore, janë rregulluar mënyrat e fitimit të pronësisë dhe titujt juridik.



Më tej duke trajtuar fitimin dhe humbjen e pronësisë dhe titujt juridik sipas Kodit Civil u theksua se ky Kod i ka specifikuar titujt juridik për fitimin e pronësisë (nenet 863-898 i KC). E drejta e pronësisë mund të fitohet në bazë të punës juridike, trashëgimisë, vendimit gjyqësor, vendimit të organit administrative dhe në bazë të ligjit (neni 863 i KC). E drejta e pronësisë sipas paragrafit 1 të këtij neni, fitohet nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e parashikuara me këtë Kod lidhur me fitimin e pronësisë në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, u demonstruan metodat bashkëkohore të ligjërimit, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore dhe shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve studimore dhe standardeve bashkëkohore të metodologjisë së mësimdhënies si dhe dispozitave ligjore që përmban Projekt-Kodi Civil i Kosovës.

Përfitues në këtë trajnim ishin trajnuesit gjyqësor të Akademisë së Drejtësisë që do të ligjërojnë në të ardhmen për Kodin Civil të Republikës së Kosovës.

Punëtorja për finalizimin e Programit Trajnues për vitin 2020

Më 12-15 nëntor 2019, Akademia e Drejtësisë realizoi “Punëtorinë për finalizimin e Programit Trajnues për vitin 2020”.


Qëllimi i punëtorisë ishte përmbledhja e punimeve dhe koncepteve të hartuara nga trajnuesit e AD-së dhe finalizimi i Programit Trajnues për vitin 2020 në përputhje me nevojat adekuate të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe në përgjithësi me sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Me rastin e kësaj punëtorie janë shqyrtuar dhe analizuar gjitha konceptet e hartuara duke i selektuar sipas fushave dhe njëkohësisht duke i përpunuar sipas metodologjisë dhe strukturës së përcaktuar. Përveç koncepteve që ishin pjesë e programit të vazhdueshëm është punuar edhe në integrimin e parimeve bazë të programit të tra-

jnimit fillestar dhe aktivitetet në komponentën e hulumtimeve dhe publikimeve duke përfshirë edhe aktivitetet tjera për stafin administrativ dhe prokurorial si dhe për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive, për gjyqtarë porotë dhe aktivitetet përmes platformës së mësimin në distancë.

Në vazhdim janë përfshirë edhe temat e propozuara nga partnerët e Akademisë dhe njëkohësisht janë integruar në program edhe ndryshimet legislative dhe kërkesat nga dokumentet strategjike.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin stafi nga Departamenti i Programit.



Takimi i Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë

Më 20 nëntor 2019, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Programor të AD-së.

Temë kryesore e diskutimit në këtë takim ishte diskutimi dhe shqyrtimi i draft Programit të Trajnimit për vitin 2020.

Anëtarët e Këshillit Programor diskutuan për strukturën dhe përmbajtjen e Programit të Trajnimit për vitin 2020, temat e përfshira në program, kohëzgjatjen e sesioneve të trajnimit si

dhe për çështje tjera të rëndësishme për zbatimin e këtij programi trajnues.

Pas shqyrtimit të temave të këtij programi, Këshilli Programor rekomandoi që Programi Trajnues 2019 të dërgohet në Këshill Drejtues për miratim me sugjerimet e tij për përfshirjen e disa temave shtesë.



Seminari për Ligjin për Komunitetin e Energjisë

Me 21 dhe 22 nëntor 2019 në Shkup të Maqedonisë Veriore, me ftesë të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorët Publikë të Maqedonisë Veriore dhe në mbështetje të Sekretariatit të Komunitetit Evropian të Energjisë u mbajt takimi dhe seminari i parë për Ligjin e Komunitetit të Energjisë.

Qëllimi i këtij seminari ishte ngritja e vetëdijes dhe njohjes së legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e energjisë, mjedisit dhe më gjerë si dhe, integrimi i këtij legjislacioni në kurrikulën trajnuese për gjyqtarët veçanërisht për gjyqtarët e fushës civile dhe administrative.

Me rastin e këtij seminari u diskutua për rëndësinë dhe zhvillimet në skenën evropiane dhe përpjekjet e shteteve që janë në proceset euro integruese në harmonizimin e plotë të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-

së dhe në këtë drejtim edhe në fushën e energjisë. Gjithashtu vëmendje të veçantë iu kushtua përfshirjes trajnimeve për gjyqtarët mbi ligjin e Komunitetit të Energjisë, Mjedisit dhe Konkurrencës që janë të rëndësishme për zhvillimin e shpejtë të vendeve aspiruese.

Në seminar morën pjesë përfaqësues të Akademive Gjyqësore nga Serbia, Mali i Zi, Gjeorgjia, Moldavia, Kosova dhe Shqipëria, si dhe Presidenti i Gjykatës Kushtetuese, Presidenti i Komisionit Rregullator të Energjisë, Presidenti i Komisionit të Konkurrencës, gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarë nga Gjykata Administrative të Shkupit, gjyqtarë e Gjykatës Civile të Shkupit, avokatët, profesorët e shkollave juridike të Maqedonisë Veriore, si dhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera përkatëse.



Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë



Prishtinë, me datë 27 nëntor 2019, në Akademinë e Drejtësisë, u mbajt takimi i gjashtë me radhë për këtë vit, ndërkaq i njëzet me radhë i kësaj përbërje të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi dhe miratimi i Programit Trajnues për vitin 2020 të AD-së, shqyrtimi i Rregullores për Trajnuesit dhe Mentorët e AD-së, zgjedhja e drejtorit Ekzekutiv të AD-së dhe çështje tjera në kuadër të mandatit të Akademisë.

Sipas agjendës së përcaktuar për këtë takim, fillimisht anëtarët e Këshillit Drejtues miratuan procesverbalin nga takimi i kaluar dhe në vijim shqyrtuan dhe miratuan Programin e Trajnimeve për vitin 2020 dhe Rregulloren për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.

Në vazhdim me kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë u aprovua përfshirja e avokatëve shtetëror në trajnimet që ofron Akademia e Drejtësisë për gjyqtarë me theks të veçantë në trajnimet në lëmine penale, civile dhe administrative.

Më pas Këshilli Drejtues sipas agjendës vazhdoi me procedurën e zgjedhjes së Drejtorit, në proces të cilit ishin tre kandidatë të rekomanduar nga ana e komisionit përzgjedhës. Në votim morën pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues të cilët unanimisht votuan për kandidatin e parë i cili ishte me pikë më shumë në raport me dy kandidatët tjerë. Pra, me votën për Drejtor Ekzekutiv të Akademisë së



Drejtësisë është zgjedhur z. Enver Fejzullahu.

Në këtë takim Këshilli Drejtues diskutoi edhe çështje të tjera të cilat janë në dobi të funksionimit të mirë të punës së Akademisë së Drejtësisë në kuadër të kompetencave dhe mandatit ligjor të saj.

<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**